



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:041405

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05763414

P.nr.15/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË KAMENICË-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sadri Krasniqi, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurit I. M. nga ....., për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrin ndëshkimor me numër PP.II.nr.113/2024 të datës 02.02.2024, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me datë 31.05.2024, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me numër PP.II.nr.113/2024 të datës 02.02.2024, ndaj të pandehurit **I.M.**, nga babai R., nëna F., e gjinisë S., i lindur me datë ....., në ....., i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me gjendje të varfër ekonomike - rast social, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Është fajtor**

Sepse me datë 05.01.2024, rreth orës 20:40, në fshatin ....., i pandehuri, i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit, B. D., në atë mënyrë që: i pandehuri, duke pretenduar se i dëmtuari e ka lajmëruar policinë për vjedhje pylli,

ka shkuar tek shtëpia e të dëmtuarit dhe e ka thirrë të dal nga shtëpia dhe në momentin që i dëmtuari ka dalur, i pandehuri, e ka kapur për krahu, e ka larguar nga oborri i shtëpisë dhe e ka goditur me grushta, duke i shkaktuar lëndime, i cili për shkak të lëndimit ka kërkuar ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan – Emergjencë.

- Me çka ka kryer veprën penale, lëndimi i lehtë trupor, nga 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës;

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38,39, 40, 43, 69, 70 dhe 71 të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPP-së të pandehurin e lartcekur:

### **E GJYKON**

Me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

I dëmtuari B. D. nga ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), shumën prej 20€ (njëzet euro) në emër të përpilimit të ekspertizës mjeko ligjore si dhe 20€ (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 02.02.2024, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.113/2024, kundër të pandehurit I. M. nga ....., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin

ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë për të pandehurin me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPP-ës.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe konform nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së, vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave e lëndës siç janë: Raporti fillestar i incidentit me nr. të rastit 2024-CL-002, i datës 05.01.2024, deklarata e të dëmtuarit B. D., deklarata e dëshmitarëve A. C., E. Q. dhe F. P., deklarata e të pandehurit I.M., raporti mjekësor me nr. 595 i datës 06.01.2024, në emër të të dëmtuarit, akt ekspertimi mjeko - ligjor i datës 02.02.2024, si dhe shkresat e tjera në lëndë dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPKR-ës.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës lëndore është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm të cilën e bënë vet e dëmtuara gjykata konsideron se këto të dhëna nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesshëm të kërkesës pasurore juridike, andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarin B.D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil. Gjykata, bazuar në nenin 449 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €,si dhe 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si dhe në bazë të nenit 134 paragrafi 6 të KPRK-së, të paguajë ekspertizën mjeko ligjore në shumë prej 20 euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2024:041405, 31.05.2024**

Gjyqtari i vetëm gjykues,

---

Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi- urdhrit ndëshkimor mundë të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, kundërshtimi i paraqitet kësaj gjykate, e pastaj gjykata do të caktoj seancën për shqyrtim kryesor në pajtim me nenin 496 parag. 4 i KPPRK-së.